

VENDIM
Nr.1069, datë 21.10.2009

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË
FAKULTETIN E GJUHËVE TË HUAJA DHE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE
NATYRORE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS, SI DHE PËR PËRCAKTIMIN E
KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR KËTO
PROGRAME STUDIUMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 1.3.1,34,42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Shkenca gjuhësore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr) në shkenca gjuhësore”;

b) Doktoratë në “Letërsi botërore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr) në letërsi botërore”.

2. Hapjen, në Fakultetin e Shkencave Natyrore të Universitetit të Tiranës, të programeve të studimeve, të ciklit të tretë, të doktoratës, si më poshtë vijon:

a) Doktoratë në “Fizikë”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr) në fizikë”;

b) Doktoratë në “Analiza kimike e lëndës dhe mjedisit”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr) në analiza kimike e lëndës dhe mjedisit”.

c) Doktoratë në “Elektrokimi e zbatuar dhe dukuritë sipërfaqësore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në elektrokimi të zbatuar dhe dukuritë sipërfaqësore”.

ç) Doktoratë në “Teknologjia dhe mikrobiologjia e ushqimeve & vlerësimi i sigorisë dhe cilësisë”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në teknologjia dhe mikrobiologjia e ushqimeve & vlerësimi i sigurisë dhe cilësisë”.

d) Doktoratë në “Proceset e trajtimit kimik të lëndëve të para natyrore dhe të mbeturinave industriale dhe urbane”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në proceset e trajtimit kimik të lëndëve të para natyrore dhe të mbeturinave industriale dhe urbane”.

dh) Doktoratë në “Biologji molekulare”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në biologji molekulare”.

e) Doktoratë në “Biologji e ruajtjes”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në biologji e ruajtjes”.

ë) Doktoratë në “Bioteknologji bimore”, në përfundim të së cilës lëshohet diploma për gradën shkencore “Doktor (Dr), në bioteknologji bimore”.

3. Kohëzgjatja e programeve të studimeve të doktoratës është, të paktën, 3 vite dhe përfshin edhe 60 kredite për studime të organizuara.

4. Kuota e pranimit në këto programe studimi, për vitin 2009, është 137 dhe ndahet sipas fakulteteve e programeve të studimit, si më poshtë vijon:

A.Fakulteti i Gjuhëve të Huaja:

a) Doktoratë në “Shkenca gjuhësore”	25 kuota;
b) Doktoratë në “Letërsi botërore”	40 kuota;
B. Fakulteti i Shkencave Natyrore:	
a) Doktoratë në “Fizikë”	10 kuota;
b) Doktoratë në “Analiza kimike e lëndës dhe mjedisit”	10 kuota;
c) Doktoratë në “Elektrokimi e zbatuar dhe dukuritë sipërfaqësore”	10 kuota;
ç) Doktoratë në “Teknologji dhe mikrobiologjia e ushqimeve & vlerësimi i sigurisë dhe cilësisë”	6 kuota;
d) Doktoratë në “Proceset e trajtimit kimik të lëndëve të para natyrore dhe të mbeturinave industriale dhe urbane”	10 kuota;
dh) Doktoratë në “Biologji molekulare”	10 kuota;
e) Doktoratë në “Biologji e ruajtjes”	10 kuota;
ë) Doktoratë në “Bioteknologji bimore”	6 kuota.

5. Për çdo program studimi, 10% (dhjetë për qind) e kuotave të mësipërme caktohet për kandidatët nga trojet shqiptare jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë dhe administrohet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas kërkesave të institucioneve përkatëse zyrtare të këtyre trojeve.

6. Tarifa e shkollimit është 200 000 (dyqind mijë) lekë dhe likuidohet për çdo vit të kohëzgjatjes normale, në këste të caktuara nga fakulteti përkatës.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i Universitetit të Tiranës.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha